QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 12065 Prot.
Datë 08.8.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

EPSA
enforcement private service

Nr. 4717 Prot

Tiranë, me 08.08.2017

Nr.106 Dosje

VENDIM

PËR FILLIMIN E MENJËHERSHËM TË EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM

Unë Julian Ahmeti , Përmbarues Gjyqësor pranë Shoqërisë së Përmbarimit "E.P.S.A" SHPK, në referim të Vendimit Per Sigurimin e Padise me Nr. 919 Akti, të lëshuar me Datë 04.08.2017 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane ,

KONSTATOVA

Se në zyrën e Shoqërisë së Përmbarimit "E.P.S.a" SHPK është depozituar kërkesa për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv, "Vendimit Per Sigurimin e Padise me Nr. 919 Akti, të lëshuar me Datë 04.08.2017 të Kreditorit – Sadik Llapashtica, i cili,

PERMBAN

Pranimin e kërkesës.

Marrja e mases se sigurimit te padise nepermjet bllokimit te llogarive bankare te shoqerise WONDER POWER SHPK prane te gjitha bankave te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise deri ne shumen 66,124,058.928 (gjashtedhjete e gjashte milion e njeqind e njezete e kater mije e pesedhjete e tete presje nenteqind e njezete e pese leke) e cila perben masen e detyrimit dhe penalitetin e llogaritur nga data 06.05.2016 deri ne daten 02.08.2017 ne te cilen eshte paraqitur kjo kerkese dhe qe buron nga marreveshja e vendosur sipas Deklarates Noteriale nr.1185 rep., nr.596 kol., date 08.03.2014 lidhur ndermjet kerkuesit Sadik Llapashtica dhe shoqerise Ë O N D E R SHPK deri ne zgjidhjen ne themel te ceshtjes.

Urdherimin e Qendres Kombetare te Biznesit te mos lejoje tjteresimin (shitje, dhurim, shkembim apo cdo veprim tjeter disponimi te kuotave te shoqerise WONDER POWER SHPK dhe te shoqerise W O N D E R SHPK si dhe ndalimin e barresimit te ketyre kuotave me cfaredolloj mjeti ligjor (peng, barre siguruese, kolateral financiar) deri ne marrjen forme te prere te vendimit te gjykates.

Bazuar ne nenin 510/a të K.Pr.Civile, vendimi per marrjen e mases se sigurimit te padise eshte titull ekzekutiv, dhe per ekzekutimin e tij nuk leshohet urdheri i ekzekutimit.

Ne kushtet kur Gjykata ka çmuar, ekzistencen e te drejtes se pretenduar, ekzistencen e frikes per mospermbushjen e kesaj te drejte si dhe kur nga informacioni i kreditorit, konstatohen prova dhe fakte konkrete, të cilat brenda një kohe të shkurtër, do të çonin në pamundësi reale të kryerjes dhe të ekzekutimit tërësor të detyrimit.

Referuar ne nenin 519 te Kodit te Procedures Civile,

VENDOSA

1. Te filloj menjëherë ekzekutimin e detyrueshëm te Vendimit Per Sigurimin e Padise me Nr. 919 Akti, të lëshuar me Datë 04.08.2017 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
2. Te filloj menjehere procesin e sekuestrimit, ne masen qe do te jete e nevojshme per plotesimin e detyrimit sipas percaktimeve te shprehura ne dispozitivin e sipertreguar.
3. Ky vendim i njoftohet debitorit së bashku me urdherat e vendosjes se sekuestros mbi pasuritë e tij, duke e njohur me të drejtën e ankimit brenda afatit ligjor të ankimit 5-ditor.

Ky vendim mbahet në 4 kopje.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "E.P.S.A"SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

Julian AHMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
JULIAN M. AHMETI
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Adresa: _____, Tiranë Tel- Fax +355

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

DHOMA KOMBËTARE
E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 4718 Prot

Tiranë, më 08.08.2017

Nr. 106 Dosje

URDHËR

(PËR EKZEKUTIMIN E MENJEHERSHEM TE VENDIMIT PER SIGURIMIN E PADISE)

Drejtuar :

Bankave Tregtare në Tiranë,

Banka Raiffeisen (BR), Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH), Veneto Banka sh.a. (VB), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka Tirana (BT), Banka Kombëtare e Greqisë (Dega Tiranë) (BKG), Banka Ndërkombëtare Tregtare (BNT), Banka Alpha Shqipëri (BA),
Banka Intesa Sanpaolo - Shqipëri (BIS), Banka Procredit (BPC), Banka Credins (BC), Banka Societe Generale Albania (BP),
Banka Union (BU) Banka e Pare e Investimeve (BPI), Banka Credit Agricole Shqiperi (CA), Banka e Kredititi Të Shqipërisë (BKSH).

Drejtuar : **Qendres Kombetare te Biznesit**
Adresa : Tirane

Unë, Julian Ahmeti , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat ***"E.P.S.A" SHPK,*** në referim të Vendimit Pr Sigurimin e Padiseme Nr.919 Akti date 04.08.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, kam vënë në ekzekutim këte *Urdhër*, duke regjistruar dosjen përmbarimore Nr. 106 Datë 08.08.2017 kërkesën e kreditorit ***Sadik Llapashtica***.

Pasi fillova menjehere procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, në referim të neneve 519 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Me ane te Vendimit Gjyqesor Per Sigurim Padie me Nr.919 Akti date 04.08.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur :

Pranimin e kërkesës.

Marrja e mases se sigurimit te padise nepermjet bllokimit te llogarive bankare te shoqerise WONDER POWER SHPK prane te gjitha bankave te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise deri ne

shumen 66,124,058.928 (gjashtedhjete e gjashte milion e njeqind e njezete e kater mije e pesedhjete e tete presje nenteqind e njezete e pese leke) e cila perben masen e detyrimit dhe penalitetin e llogaritur nga data 06.05.2016 deri ne daten 02.08.2017 ne te cilen eshte paraqitur kjo kerkese dhe qe buron nga marreveshja e vendosur sipas Deklarates Noteriale nr.1185 rep., nr.596 kol., date 08.03.2014 lidhur ndermjet kerkuesit Sadik Llapashtica dhe shoqerise W O N D E R SHPK deri ne zgjidhjen ne themel te ceshtjes.

Urdherimin e Qendres Kombetare te Biznesit te mos lejoje tjteresimin (shitje, dhurim, shkembim apo cdo veprim tjeter disponimi te kuotave te shoqerise WONDER POWER SHPK dhe te shoqerise W O N D E R SHPK si dhe ndalimin e barresimit te ketyre kuotave me çfaredolloj mjeti ligjor (peng, barre siguruese, kolateral financiar) deri ne marrjen forme te prere te vendimit te gjykates.

Përsa më sipër, në referim të neneve 519, 593 dhe 594 te K.Pr.Civile, si edhe Udhëzimit Nr 2 Datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë, "Për Ekzekutimin e Detyrimeve Mbi Shumat e Llogarive Në Bankë".

URDHËROJ

1- Bankat e nivelit te dyte te kryejne menjehere Bllokimin e menjehershem te llogarive bankare te shoqerise WONDER POWER SHPK me (numra Nipti) Nr.Nipt K39003403C dhe Nr.Nipti K49312433J dhe shoqerise W O N D E R SHPK me Nr.Nipt K11624001V prane te gjitha bankave te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise deri ne shumen 66,124,058.928 (gjashtedhjete e gjashte milion e njeqind e njezete e kater mije e pesedhjete e tete presje nenteqind e njezete e pese leke) e deri ne zgjidhjen ne themel te ceshtjes. ***(Bashkangjitur ketij urdheri do te gjeni vendimin per sigurimin e padise me Nr.919 Akti date 04.08.2017).***

2- Qendra Kombetare e Biznesit, menjehere te mos lejoje tjetersimin (shitje, dhurim, shkembim apo cdo veprim tjeter disponimi te kuotave te shoqerise WONDER POWER SHPK me (numra Nipti) Nr.Nipt K39003403C dhe Nr.Nipti K49312433J dhe te shoqerise dhe shoqerise W O N D E R SHPK me Nr.Nipt K11624001V si dhe ndalimin e barresimit te ketyre kuotave me çfaredolloj mjeti ligjor (peng, barre siguruese, kolateral financiar) deri ne marrjen forme te prere te vendimit te gjykates. ***(Bashkangjitur ketij urdheri do te gjeni vendimin per sigurimin e padise me Nr.919 Akti date 04.08.2017).***

3- Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me proceduren e vënies së sekuestros nga ana juaj konform parashikimeve ligjore.

4- Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju bëj me dije se:

a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim para Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhri.

c) Ky urdhër mbahet në 19 (nëntëmbëdhjetë) kopje.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "E.P.S.A" SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

Julian AHMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË JULIAN M. AHMETI PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.919 Akti
Dt.regj.02.08.2017

Dt.04.08.2017

VENDIM
PER SIGURIMIN E PADISE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtare : FATIME DEÇOLLI

Sot më datë **04.08.2017** mori në shqyrtim pa pranine e paleve,kërkesën që i përket :

KERKUES: **Sadik Llapashtica**,i biri i Ram,me dtl.20.01.1960,banue ne Tirane,i identifikuar me pashaporte me nr.BR7469039.Perfaqesuar ne gjykim me prokure te posacme me nr.688 rep dhe nr.122 kol dt.02.08.2017 nga av.Ina Kodra me nr.6429 license Dhoma e Avokatise Tirane.

OBJEKTI: Marrja e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet:
-Bllokimit të llogarive bankare të shoqerise WONDER POWER SHPK shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB) me nr. NUIS: K39003403C dhe NUIS K49312433J, me adresë: Bogove BOGOVE Fshati Bogovedhe dhe shoqerise W O N D E R SHPK shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB) me nr. NUIS: K11624001V, me adresë: Njësia bashkiake nr. 2, rruga Leke Dukagjini, pallati përballë QKR, qendra e biznesit, kati i 2, Tiranë, pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë deri në shumën 66.124.058.925 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e njëzet e katër mijë e pesëdhjetë e tetë presje nëntëqind e njëzetë e pesë lekë) e cila përbën masën e detyrimit dhe penalitetin e llogaritur nga data 06.05.2016 deri në datën 02.08.2017 në të cilën është paraqtiur kjo kërkesë dhe që buron nga marrëveshja e vendosur sipas Deklartës Noteriale nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014 lidhur ndërmjet kërkuesit Sadik Llapashtica dhe shoqërisë W O N D E R SHPK në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë WONDER POWER SHPK deri në zgjidhjen në themel të çështjes;
-Urdhërimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit të mos lejojë tjetërsimin (shitje, dhurim, shkëmbim apo cdo veprim tjetër disponimi) të kuotëve

shoqërisë WONDER POWER SHPK dhe të shoqërisë W O N D E R SHPK si dhe ndalimin e barrësimit të këtyre kuotave me çfarëdolloj mjeti ligjor (peng, barrë siguruese, kolateral financiar) deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës.

BAZA LIGJORE: Neni 204,205 te K.Pr.Civile.

Gjyqtari pasi administroi dhe shqyrtoi provat shkresore te depozituara nga kerkuesi se bashku me kerkesen per sigurimin e padise.

V E R E N :

Se,kërkuesi **Sadik Llapashtica** ka paraqitur para Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane kërkesën me objekt te siper cituar.

Kerkesa u shqyrtua nga gjyqtari pa pranine e paleve,ne dhome keshillimi,referuar parashikimeve ne nenin 205 te K.Pr.Civile,i ndryshuar me nenin 67 te ligjit Nr.38/2017 **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË",TË NDRYSHUAR.**
Kerkesa per sigurimin e padise bazohet ne nenin 204 te K.Pr.Civile, pra eshte paraqitur perpara ngritjes se padise se themelit, e cila ka te beje me zgjidhjen e nje mosmareveshje kontraktore.

Nga aktet e administruara ne dosje se bashku me kerkesen,si dhe nga shqyrtimi i kerkeses se depozituar nga kerkuesi,rezulton e vertetuar se:

Kërkuesi Sadik Llapashtica ka qënë aksionar në shoqërinë WONDER POWER SHPK dhe ka zotëruar 50% të kapitalit të kësaj shoqërie, ndërsa pjesa tjetër prej 50% e kapitalit është zotëruar nga aksionari tjetër W O N D E R SHA (sot W O N D E R SHPK).

Me Kontratën Noteriale me nr. 428 Rep. dhe nr. 273 Kol. datë 01.02.2014 kërkuesi z. Sadik Llapashtica ka tjetërsuar 50% të aksioneve të zotëruara në Shoqërinë "WONDER POWER" SHPK tek shoqëria W O N D E R SHPK, kundrejt çmimit 1,000,000 EUR (një milion euro).Në paragrafin 5 të pikës 2 të kësaj Kontrate, palët kanë parashikuar se:
Përfundimi i disponimit të dividentit. *Pavarësisht nga data e kryerjes së pagesës së plotë të 90 aksioneve dhe pavarësisht nga data e firmosjes së kësaj kontrate, Shitësi (Sadik Llapashtica) do të gëzojë të gjitha të drejtat si aksionar përfshirë të drejtat ekonomike dhe financiare, dividentit etj, në përkatësinë e të gjithë aksioneve të tij zotëruese në shoqërinë WONDER POWER SHA, deri në datën e kryerjes së pagesës së plotë të vlerës të 90 aksioneve me numër rendor nga 91 deri në 180 të zotëruara prej tij. Cdo përfitim që është parashikuar më parë midis palëve referuar bilancit të shoqërisë, ekzekutohet sipas marrëveshjeve dhe mënyrës që palët kanë rënë dakord midis tyre para firmosjes së kësaj kontrate.*

Në vijim, ndërmjet kërkuesit Sadik Llapashtica dhe të shoqërisëW O N D E R SHPK (ish W O N D E R SHA) është lidhur marrëveshja "Deklaratë Noteriale" nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014.Në këtë marrëveshje, palët kanë parashikuar ndër të tjerash se:

"...Më datë 01.02.2014, kemi nënshkruar kontratën e shitblerjes së aksioneve sipas së cilës, askonari Sadik Llapashtica shet 50% te aksionve në shoqerinë WONDER POWER SHA dhe W O N D E R SHA, perfaqesuar nga aksionari i vetëm i saj z. Vasil Gjika blen këto 50% aksione.

Në paragrafin "Përfundim i disponimit të dividentit" është përcaktuar edhe marrëveshja e dakordësia mes palëve.....Aksionari W O N D E R SHA (sot W O N D E R SHPK), deklaron se i njeh aksionarit Sadik Llapashtica (shitësi) gjithashtu të drejtën për fitimin që shoqëria WONDER POWER SHA (sot WONDER POWER SHPK).pret të arkëtojë nga ana e KESH SHA, për shkak të marrëdhënies së detyrimit të krijuar gjatë viteve 2007 deri 30 Prill 2012 si pasojë e aplikimit të gabuar nga ana e KESH dhe CEZ Shpërndarje të koeficientit jo të plotë të transformimit të energjisë në HC Bogovë. Ky proces është në gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në momentin që shoqëria do të kreditojë shumën prej 22,435,256 lekë ***apo cilëndo vlerë për këtë shkak, aksionari W O N D E R SHA, (blerësi) në cilësinë e aksionarit të vetëm të aksionarit të saj, do të marrë të gjitha masat për të shpërndarë divident duke i njohur Aksionarit Sadik Llapashtica (shitësi) të drejtën për divident në masën 50% të fitimit që do të realizojë shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor nga shuma që është kërkuar të arkëtohet prej 22,435,256.*** *Ky veprim i kalimit të shumës takuese në masën 50% të fitimit të vlerës së plotë arkëtuese prej 22,435,256 nga ana e KESH sha, do t'i kalohet z. Sadik Llapashtica,* ***brenda 10 ditëve nga data e arkëtimit të shumës së plotë në llogarinë e WONDER POWER SHA (sot WONDER POWER SHPK), ose në cilëndo emër tjetër të shoqërisë nëse emri apo statusi i WONDER POWER SHA, ka ndryshuar.***

Nëse kjo shumë nuk kalohet në afatin e përcaktuar më sipër, blerësi W O N D E R SHA, përfaqësuar nga z.Vasil Gjika, do të paguajë një penalitet 1% të shumës takuese për cdo ditë vonesë..."

Referuar marrëveshjes së sipërcituar të palëve, procesi gjyqësor i zhvilluar me kërkues shoqërinë "WONDER POWER" SHPK kundër të paditurit Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), përfundoi me pranimin e padisë së kërkuesit sipas Vendimit nr. 2368 datë 24.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me Vendimin nr. 428, datë 01.03.2016. Bazuar në këto dy vendime, ***i paditurit KESH SHA, u detyrua t'i paguante kërkuesit shumën prej 23,484,589 lekë si detyrim kontraktor si dhe fitim të munguar të kësaj shume në masën 5,709,256 lekë.***

Me shkresën e datës 8 Shtator 2016, kërkuesi Sadik Llapashtica, nëpërmjet avokatit të tij përfaqësues, i është drejtuar Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, për të marrë informacion prej kësaj shoqërie, nëse ka ekzekutuar vendimet e sipërcituara të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit, duke i paguar shoqërisë "WONDER POWER" shpk, vlerën prej 23,484,589 lekë si detyrim kontraktor si dhe fitim të munguar të kësaj shume në masën 5,709,256 lekë.

Me shkresën nr. 7609/1 Prot., datë 14.09.2016, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), në përgjigje të shkresës së sipërcituar të kërkuesit Sadik Llapashtica, ka konfirmuar se shuma prej 23,484,589 lekë si detyrim kontraktor si dhe fitim të munguar të kësaj shume në masën 5,709,256 lekë, është paguar nga kjo shoqëri **në datë 26.04.2016**.

Me kerkesen object gjykimi, drejtuar kesaj gjykate,kerkuesi pretendon se:

Pavaresisht ketij arketimi ne favor te tyre,Shoqëria WONDER POWER shpk, me ortak të vetëm shoqërinë W O N D E R SHPK, nuk kanë zbatuar marrëveshjen e lidhur sipas Deklaratës Noteriale nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014 dhe nuk kanë paguar brenda 10 ditëve nga data 26.04.2016 **në favor të kërkuesit** Sadik Llapashtica, 50% të vlerës së arkëtuar në këtë datë nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) si rezultat i

zbatimit të vendimit nr. 2368 datë 24.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lënë me fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. 428, datë 01.03.2016.

Gjithashtu, sipas vendimit datë 25.06.2017 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë WONDER POWER SHPK, për miratimin e bilancit të kësaj shoqërie për vitin ushtrimor 2016, rezulton se është bërë shpërndarja e dividentit tek ortaku i vetëm W O N D E R SHPK në vlerën 36,178,202 lekë me vendim të shoqërisë W O N D E R SHPK, dhe pavarësisht këtij fakti, shoqëria WONDER POWER SHPK nuk ka marrë asnjë masë për të paguar ndaj kërkuesit shumën e dakordësuar sipas marrëveshjes "Deklaratë Noteriale" nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014 sipas sëcilës: .... ***aksionari W O N D E R SHA (blerësi) në cilësinë e aksionarit të vetëm të aksionarit të saj, do të marrë të gjitha masat për të shpërndarë divident duke i njohur Aksionarit Sadik Llapashtica (shitësi) të drejtën për divident në masën 50% të fitimit që do të realizojë shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor nga shuma që është kërkuar të arkëtohet prej 22,435,256.***

Konkretisht, referuar regjistrit tregtar publik të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve datë 25.06.2017 të shoqërisëWONDER POWER SHPK, kjo shoqëri ka shpërndarë dividend dhe ka marrë vendimmarrje per te tjera zgjidhje financiare,duke anashkaluar detyrimin ndaj kerkuesit.

Pra,deri ne keto moment,rezulton se shoqëria WONDER POWER shpk, me ortak të vetëm shoqërinë W O N D E R SHPK nuk kanë përmbushur detyrimin ndaj kërkuesit sipas marrëveshjes "Deklaratë Noteriale" nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014, duke mos i paguar këtij të fundit shumën prej ALL 14,596,922.5 (katërmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzetë e dy presje pesë lekë), edhe pse kjo shumë është ekzekutuar dhe arkëtuar nga shoqëria KESH SHA në datë 26.04.2016 në favor të shoqërisë "WONDER POWER" SHPK. Pra, ndodhemi në kushtet kur, Shoqëria WONDER POWER SHPK, me ortak të vetëm shoqërinë W O N D E R SHPK nuk kanë vullnet për të paguar shumën e sipërcituar në favor të kërkuesit.

Pra, shoqëria "WONDER POWER" ka rezultuar me një fitim prej ALL 38, 082, 335 për vitin ushtrimor 2016 dhe një pjesë e këtij fitimi i është shpërndarë shoqërisëW O N D E R SHPK si dividend,e'ka do te thote se ekziston rreziku që në mungesë të një vendimi nga gjykata, keto shoqeri të boshatisin llogaritë bankare duke i tjetërsuar këto shuma apo duke i përdorur ato për arsye të ndryshme si dhe të tjetërsojnë me çfarëdo mjeti ligjor kuotat e tyre, dhe për pasojë të cënojnë interesin pasuror të kërkuesit i cili, nëse gjykata nuk vendos marrjen e masës së sigurimit, nuk do të realizojë kurrë të drejtën e tij.

Për këtë arsye, gjykata duhet të vendosë marrjen e masës së sigurimit të padisë sipas objektit te përcaktuar, sepse në këtë rast ekzistojnë të dy kushtet themelore për vendosjen e masës së sigurimit,sipas objektit te padise.

Për të provuar këtë fakt, kërkuesi në mënyrë që të sigurojë vlerën e kërkimit të tij në padi dhe fillimisht në këtë kërkesë, kërkon bllokimin e llogarive bankare dhe mos tjetërsimin dhe mos disponimin e kuotave në edo formë dhe me edo mjet ligjor të shoqërisë "WONDER POWER" SHPK dhe shoqërisë W O N D E R SHPK. Në referim të praktikës unifikuese, gjendja e këtyre likuiditeteve dhe aseteve të këtyre dy shoqërive për shumën e paraqitur në objektin e kësaj kërkese të gjykimit, duhet të mbetet " e ngrirë" dhe e patjetërsuar tek të tretët, duke bërë të mundur që në varësi të vendimit përfundimtar që do të japë gjykata, kërkuesi të mund të realizojë të drejtat e pretenduara prej tij. Gjithashtu, kjo masë sigurimi e kërkuar bën të mundur që shoqëria "WONDER POWER" SHPK dhe

shoqëria W O N D E R SHPKtë mos munden dot të realizojnë tjetërsimin e shumave që këto shoqëri kanë gjendje në llogaritë e tyre bankare dhe tjetërsimin e disponimin e kuotave të tyretek të tretë, për të shmangur në këtë mënyrë mospërmbushjen e detyrimit që ato kanë ndaj kërkuesit.

Ne shqyrtimin e kerkese kjo gjykate pati parasysh dispozitat e K.Pr.Civile te cilat rregullojne te drejten e kerkuar me kerkesen e paraqitur gjykates.Keshtu, Kodi i Procedurës Civile përcakton se:

Neni 202

Me kërkesën e paditësit, gjykata lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohet kur:

a) padia mbështetet në prova me shkresë;

b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

Neni 204

Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.

Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë.

Neni 205

Sigurimi i padisë mund të lejohet për të gjithë padinë, ose vetëm për ato pjesë të saj, që gjykata i gjen të bazuara, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 202 të këtij Kodi.

Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër.

Neni 206

Llojet e masave për sigurimin e padisë

Sigurimi i padisë bëhet:

b) me marrjen nga gjykata te masave te tjera te pershtatshme ,duke perfshire edhe pezullimin e ekzekutimit.

Po keshtu kjo gjykate iu referua dhe pati parasysh edhe Vendimin Unifikues te Gjykates se Larte nr.10, date 24.03.204. I cili konkludon se:`` **nepermjet marrjes se mases se sigurimit te padise gjykata synon "te mbaje gjendjen ashtu sic eshte", apo "te ngrire" deri ne zgjidhjen perfundimtare te konfliktit, e cili per vete natyren e ceshtjes, duhet te realizohet nepremjet nje procedure te shpejte dhe relativisht te thjeshte. Nepermjet marrjes se mases se sigurimit te padise jo vetem sigurohet e drejta e pretenduar, e cila perben dhe teresin dhe thelbin e kerkimit, por ne te njeten kohe marrja e kesaj mase siguron efektivitetin dhe dobishmerine e procesit gjyqesor``.**

Arsyetimi ligjor i gjykates:

Marrja e mase se sigurimit te padise vendoset nga gjykata ne rastet kur ekzistojne te pakten dy kushte themelore:

a- Ekzistenca e mundshme e një **të drejte** për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË JULIAN M AHMETI PËRMBARUES GJYQESOR PRIVAT

b- Ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Në lidhje me kushtin e parë, Gjykata çmon se në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë ,për të krijuar bindje në lidhje me mundësinë e ekzistencës të së drejtës që kërkohet të rivendoset, për gjykatën është e mjaftueshme që padia të jetë e mbështetur në prova shkresore, pasi këto të fundit i lejojnë gjykatës që të krijojë një njohje të shpejtë të së drejtës që pretendohet se është shkelur.

Ne rastin ne gjykim.vertetohet e drejta e pretenduar me prova shkresore : Deklarate notetriale me nr.1185 rep dhe nr.596 kol dt.08.03.2014 etj.(cituar ne pjesen e mesiperme te ketij vendimi).

Në lidhje me kushtin e dytë që duhet të plotësohet për marrjen e një mase sigurim padie (ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet, do të bëhet i pamundur ose i vështirë). Gjykata cmon se në çështjen objekt gjykimi, marrja e kësaj mase është e domosdoshme. Duke patur parasysh dhe pretendimet e ngritura nga pala kerkuese gjatë gjykimit dhe të vërtetuara me prova shkresore, ekziston mundësia që ekzekutimi i vendimit që do të marrë gjykata për të drejtën e pretenduar mund të bëhet i pamundur ose i vështirë. Kjo pasi, të dyja këto shoqëri "WONDER POWER" SHPK dhe W O N D E R SHPK, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të paguar ndaj kërkuesit shumën e dakordësuar në marrëveshjen e sipërcituar, shumë e cila është në një vlerë të konsiderueshme dhe rreziku për mos përmbushje është shumë i dukshëm, prandaj të drejtat potenciale të kërkuesit (nëse kjo padi do të pranohet nga gjykata) duhet të mbrohen nga bërja e pamundur e ekzekutimit të vendimit gjyqësor e cila do të shkaktonte një dëm të pariparueshëm për kërkuesin.

Ky qendrim eshte mbajtur dhe nga Gjykata e Larte ne vendimin e saj unifikues dhe nga Kolegji Civil i kesaj gjykate ne raste te tjera.Ligji procedurial, ne nenin 204 te K.Pr.Civile, ka parashikuar rastin qe kerkuesi perpara ngritjes se kerkese padise te kerkoje perpara gjykates marrjen e masave te sigurimit te padise, duke i provuar gjykates sa me siper u citua.

Nga ana tjeter,me qellim mos abuzimin me kete te drejte dhe me qellimin perfundimtar zgjidhjen ne themel te konfliktit, nepermjet procesit gjyqesor,ligjvenesi ka parashikuar, po ne kete dispozite, detyrimin e kerkuesitt qe brenda 15 ditesh nga marrja e mases se sigurimit te padise te depozitoje ne gjykate kerkese padine e themelit.

Gjate gjykimit te kesaj ceshtje nepermjet provave shkresore te meposhtme, si:

-Deklarate notetriale me nr.1185 rep dhe nr.596 kol dt.08.03.2014,
-3 flete Kontributet e Ortakeve per vitet 2011-2013,
-Vendim me dt.15.06.2006,
-Vendim i asamblese se pergjithshme te aksionereve,2 cope,
-Vendim me dt.29.08.2006,
-4 flete nxjerrje llogarie bankare,
-2 flete proces verbal dt.10.02.2011,
-Proces verbal dt.30.03.2010,
-Kthim pergjigje dt.14.09.2016,
-Shkrese dt.12.06.2016,dt.19.04.2016,dt.09.09.2016,
-Vertetim dt.02.08.2017,2 kopje,
-Vendim dt.25.06.2017,2 kopje;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
JULIAN M AHMETI
-PËRMBARUES GJYQESOR PRIVAT-

gjykata cmon se, u provua ekzistenca e te drejtes se pretenduar, ekzistences se frikes per mospermbushjen e kesaj te drejte si dhe fakti qe kerkuesi kete te drejte kerkon ta rivendos nepermjet nje procesi gjyqesor.

Perfundimisht, gjykata cmon se kerkesa e kerkuesitt per marrjen e mases se sigurimit te padise duhet te pranohet, me qellimin e vetem garantimin e ekzekutimit te nje vendimi gjyqesor ne te ardhmen.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 202, 204,205 te K.Pr.Civile

V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses.

-Marrja e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet bllokimit të llogarive bankare të shoqerise WONDER POWER SHPK pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë deri në shumën 66,124,058.925 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e njëzet e katër mijë e pesëdhjetë e tetë presje nëntëqind e njëzetë e pesë lekë) e cila përbën masën e detyrimit dhe penalitetin e llogaritur nga data 06.05.2016 deri në datën 02.08.2017 në të cilën është paraqtiur kjo kërkesë dhe që buron nga marrëveshja e vendosur sipas Deklartës Noteriale nr. 1185 Rep., nr. 596 Kol., datë 08.03.2014 lidhur ndërmjet kërkuesit Sadik Llapashtica dhe shoqërisë W O N D E R SHPK deri në zgjidhjen në themel të cështjes.

-Urdhërimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit të mos lejojë tjetërsimin (shitje, dhurim, shkëmbim apo edo veprim tjetër disponimi) të kuotave të shoqërisë WONDER POWER SHPK dhe të shoqërisë W O N D E R SHPK si dhe ndalimin e barrësimit të këtyre kuotave me çfarëdolloj mjeti ligjor (peng, barrë siguruese, kolateral financiar) deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës.

-Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

-Kunder ketij vendimi lejohet ankim I vecante ne Gjykaten e Apelit Tirane.

U shpall në Tiranë, sot më dt.04.08.2017.

G J Y Q T A R E
FATIME DEÇOLLI

SHPENZIMET GJYQESORE

Takse Regjistrimi	200 leke
Fletethirrje	1 me vlere me nga 100 leke/copa ne llogari te gjykates
TOTALI	**300 LEKE**

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE JULIAN M AHMETI PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT